



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:055206

Datë: 18.01.2024

Numri i dokumentit: 05209042

C.nr.344/21

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin individual Genc Hasani, në çështjen juridike kontestimore të paditëses: S.T. nga M. të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sheremet Ademi dhe Leutrim Ademi avokat me seli në Mitrovicë, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Lirim Zeka avokat ne Prishtinë, lidhur me çështjen kontestuese kompensim i ushqimit (shujtës ditore) vlera e kontestit 1260 euro, jashtë seance me datë 18.01.2024 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT** si e bazuar kërkesëpadia e paditëses: S. T. nga Mitrovica, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të kompensimit për ushqim (shujtës ditore ne shumën prej 2 euro) gjatë punës për periudhën kohore prej 24.03.2018 deri me 11.03.2020, gjithsej për 428 ditë pune, shumën në lartësi prej 856.00€, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë 24.03.2021 e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
- II. REFUZOHET PJESËRISHT** si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses sa i përket periudhës kohore prej 18.04.2017 e deri me 23.03.2018 gjithsej për 202 dite pune apo shumen e përgjithshëm prej 404.00 € me kamatë ligjore prej 8%, nga data 24.03.2021(date e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
- III. DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës – Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëses t'i paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 125.00€, të gjitha këto t'i përmbush në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarit të saj, pranë kësaj gjykate, me datë 24.03.2021, kanë parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti për kompensim për ushqim gjatë punës. Tutje ne precizimin e padisë i njëjti ka theksuar se paditëses për periudhën kohore prej 18.04.2017 e deri me 11.03.2020 nuk i është bërë kompensimi për ushqim(shujte-ditore ne shumen prej 2 euro) edhe pse janë plotësuar kushtet e përcaktuara me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë.

Gjykata, pas shqyrtimit paraprakë te padisë ka nxjerr aktvendim për përgjigje ne padi C.nr.344/2021 te datës 09.12.2023, duke e paralajmëruar edhe me pasojat procedurale se nëse nuk parqet përgjigje në padi në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit te aktvendimit të lartpërmendur, gjykata do të merr aktgjykim në bazë të pa dëgjueshmërisë / mosbindjes.

E paditua aktvendimin e lartcekur e ka pranuar me datë 13.12.2023 (e cila është konfirmuar përmes fletë kthesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës), e njëjta me datën 26.12.2023 ka paraqitur përgjigje në padi dhe ka theksuar meqenëse paditësja ka bashkangjitur prova me ane te të cilave vërtetohet fakti se e njëjta është e punësuar pranë te paditurës si dhe dëshmon ditët e prezencës ne pune e paditura e pohon pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses pasi qe e njëjta ka paraqitur padi me datën 24.03.2021 me anë të se cilës ka kërkuar kompensimin prej datës 18.04.2017 deri me 10.03.2020 andaj ne baze te nenit 87 te ligjit te punës përcaktohet *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës ne para, parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes se kërkesës”* andaj ne rastin konkret paditësja ka pasur te drejte te kërkojë kompensimin ne emër te shujtës ditore vetëm për periudhën kohore prej 24.03.2018 deri me datën 11.03.2020 pasi qe periudha paraprake prej datës 18.04.2017 deri me date 24.03.2018 është parashkruar.

Gjykata pas pohimit pjesërisht te padisë dhe kërkesëpadisë se paditëses nga ana e te paditurës me përgjigjene padi te dhëne me dt.26.12.2023 konstatoj se kërkesa është e disponushme për palën dhe nuk është e njëjta ne kundërshtim me dispozitën ligjore te nenit 3 te LPK –se.

Me rastin e pranimit të përgjigjes në padi, gjegjësisht vlerësimit të pretendimeve të palëve e në lidhshmëri me vlerësimin e provave të bashkangjitura, kjo Gjykatë erdhi në përfundim se mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese gjendja faktike, rrjedhimisht nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e një vendimi meritor pa caktuar fare seancë gjyqësore në kuptim të dispozitës nga neni 398 të LPK-së, e cila përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*

Nga provat e bashkangjitura në padi, Gjykata konstatoi se paditësja S. T., është në marrëdhënie pune tek e paditura, gjegjësisht është i punësuar në vendin e punës si mësimdhënës në SHML “Dr. Xh. D.” në M. Po ashtu, u vërtetua se përgjatë periudhës kohore 18.04.2017 deri me datë 11.03.2020, paditësja ka qenë prezentë në vendin e punës për 630 ditë pune. Faktet e tilla vërtetohen në bazë të kontratës së punës nr. protokollit 156, të datës 05.09.2016, si dhe

vërtetimit për ditët e pranisë në punë nr.78, të dt.19.03.2021, të lëshuar nga Shkolla e Mesme e Lartë “Dr. Xh. D.” në M.. Provave materiale të lartcekura, Gjykata ua fali besimin e plotë në kuptim të dispozitës nga neni 329 par.1 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.”*

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, Gjykata vlerëson se në rastin konkret duhet të aplikohen dispozitat e Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë e miratuar dhe e nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) me datë 18.04.2017.

Çështja e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, parashihet me dispozitën nga neni 35 par.7 të Kontratës së lartcekur, ku është përcaktuar se: *“Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim”*.

Mbi këtë bazë, Gjykata vlerëson se paditësja është legjitimuar të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura përmes rrugëve gjyqësore, respektivisht është krijuar marrëdhënia e detyrimeve mes palëve ndërgjyqësve, në kuptim të dispozitës nga neni 245 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Referuar dispozitave të lartcekura, gjykata me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit për ushqimin gjatë punës (shujtave) mori për bazë vërtetimin për ditët e pranisë në punë nr.78, të dt.19.03.2021, të lëshuar nga Shkolla e Mesme e Lartë “Dr. Xh. D.” në Mitrovicë, nga i cili rezulton se paditësja S. T. për periudhën 24.03.2018 deri me 11.03.2020 ka qenë në punë 428 ditë. Prandaj për 428 ditë pune asaj i takon kompenzimi në lartësi prej 856.00€, (sipas përlllogaritjes 428 ditë x 2€ = 856.00€).

Gjykata ka refuzuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses sa i përket periudhës kohore prej 18.04.2017 e deri me 23.03.2018 gjithsej për 202 dite apo shumen prej 404.00 euro pasi që e njëjta kërkesë është parashkruar duke u mbështetur në nenin 87 të ligjit të punës përcaktohet *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës”* meqenëse paditësja ka paraqitur padi me datën 24.03.2021 periudha e lartcekur është parashkruar pasi që ka kaluar afati prej 3 vitesh kur paditësja ka pasur të drejtë të kërkojë kompensimin në emër të shujtës ushqimore, andaj në bazë të kësaj gjykata ka vendosur si në piken II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata arriti të konstatoi saktë numrin e ditëve të punës prej 202 ditë për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me 23.03.2018, në shumën prej 404.00 Euro.

Gjykata në mbështetje të nenit 452 të LPK-së vendosi si në piken III të dispozitivit, ashtu që e detyroj të paditurën që në emër të shpenzimeve paditura të paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padisë në shumë prej 104.00€ - sipas tarifës së OAK, si dhe në emër të taksës gjyqësore shumen prej 21.00€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, e në mbështetje të neni 148 të LPK, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.344/21, datë 18.01.2024

Gjyqtari
Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.